

LIGJ
Nr. 94/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË
TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS ENERGJETIKE, FAZA II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.9.2017

Shpallur me dekreten nr. 10628, datë 9.10.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË
KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS
ENERGJETIKE, FAZA II”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës
Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet
bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, të datës 12 korrik 2016, dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 29 nëntor 2016 (nota verbale nr. 349/2016), kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 2 032 179,23 euro (me fjalë: dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro, njëzet e tre cent), për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua, shuma të tjera financimi, për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit, të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk do të lidhen brenda vitit aktual. Afati për shumën e përmendur mbaron më 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të marrësve të shumës së financimit, në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave, të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese, me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikën Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 2.5.2017, në dy origjinale, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË